**L I G J**
**Nr.8075, datë 22.2.1996**

**PËR SISTEMIN BANKAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 16 e 17 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni l

1. Ky ligj do të zbatohet për bankat dhe për institucionet financiare, që kryejnë veprimtari bankare, me përjashtim të subjekteve që , në bazë të natyrës a madhësisë së veprimtarisë dhe origjinës së burimeve të mjeteve të tyre, do të përjashtohen nga zbatimi i këtij ligji në tërësi a pjesërisht nga Banka e Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë, me akt nënligjor, i bën institucionet financiare që nuk janë banka dhe që nuk kryejnë veprimtari bankare, subjekt të dispozitave të nxjerra prej saj, në zbatim të këtij ligji.

3. Institucionet financiare dhe subjektet e tjera që shkelin dispozitat e nenit 5 do të jenë objekt i kreut VII të këtij ligji.

Neni 2
**Përkufizime**

Përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj, me termat e mëposhtme do të kuptojmë:

"Administrator" nënkupton çdo person zyrtar të një institucioni financiar që kryen veprimtari bankare, ose person tjetër juridik, duke përfshirë çdo anëtar të këshillit të drejtuesve ose të komitetit të kontrollit dhe më tej çdo person që i vetëm ose bashkë me një a më shumë persona të tjerë ka autoritet për çdo angazhim në veprime, për llogari të një personi të tillë juridik.

"Bankë" nënkupton një institucion financiar me çdo lloj emri të njohur që pranon depozita, jep kredi, paguan çeqe dhe kryen shërbimet që lidhen me veprimtaritë përkatëse për publikun.

"Kapitali" nënkupton pasuri neto ose fondet e veta të një institucioni financiar, që është diferenca ndërmjet mjeteve dhe detyrimeve të tij, në përputhje me llogaritë e bilancit.

"Shpërndarja e kapitalit" nënkupton shpërndarjen e parave ose të çdo pasurie tjetër nga ana e institucionit financiar për pronarët e tij, e bërë për llogari të asaj pronësie, por që nuk përfshin:

i) çdo divident që ka të bëjë vetëm me aksionet e institucionit ose të drejtat për të blerë aksione të tilla, ose

ii) çdo shumë të paguar për depozitat e një banke kooperative që Banka e Shqipërisë e përcakton se nuk është "shpërndarje kapitali".

"Depozitë" nënkupton një shumë parash e paguar me këto kushte:

i) që kjo shumë parash do të ripaguhet me ose pa interes apo shtesë të çdo lloji, me kërkesë ose në afat, ose sipas kushteve të pranuara nga personi që bën pagesën dhe personi që e merr atë ose; dhe

ii) që kjo shumë nuk i referohet depozitës së pronësisë apo shërbimeve ose dhënies së garancisë e faktuar ose jo me një regjistrim në regjistrin e personit, që merr shumën ose me çdo faturë çertifikatë, dëftesë apo çdo dokument tjetër.

"Interes pronësie" nënkupton çdo të drejtë pronësie ose çdo tëdrejtë votimi në lidhje me një person juridik ose ndërmarrës.

"Institucion financiar" nënkupton një person juridik a fizik të angazhuar në veprimtaritë

tregtare të pranimit të depozitave nga publiku në Republikën e Shqipërisë dhe të përdorimit të fondeve të tilla tërësisht ose pjesërisht për të dhënë kredi apo bërë investime për llogari të personit që e kryen veprimtarinë tregtare, i cili mbart dhe rrezikun.

"Depozita të individit" nënkupton depozitat e personave fizikë.

"Person" nënkupton një individ, ortakëri, shoqatë dhe çdo grup të personave që veprojnë së bashku, pavarësisht nëse janë ose jo të organizuar.

"Kapital minimal i kërkuar" nënkupton kapitalin e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë kohë pas kohe për qëllime rregullatori.

"Interes (pjesë, disponim) i konsiderueshëm" nënkupton disponimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një interesi pronësie ose subjekt që përfaqëson 20 për qind a më shumë ose të të drejtave votuese, ose që i jep mundësi të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm mbi drejtimin a politikat e atij personi ose veprimi të ndërmarrë.

"Filial" nënkupton çdo person juridik, në të cilin një subjekt tjetër ose grup subjektesh që veprojnë së bashku:

i) disponojnë ekuivalentin e 50 për qind a më shumë të vlerës nominale të aksioneve me të drejtë vote, ose

ii) fitojnë disponimin e konsiderueshëm, duke e lejuar këtë subjekt ose grup subjektesh të ushtrojnë kontroll efektiv mbi drejtimin ose politikat e filialit.

Neni 3

Sistemi bankar në Republikën e Shqipërisë organizohet në dy nivele. Në nivelin e parë bën pjesë Banka e Shqipërisë, statusi i së cilës caktohet me ligj të veçantë. Në nivelin e dytë bëjnë pjesë bankat e tjera.

Neni 4

Banka themelohet si bankë shtetërore ose private me kapital tërësisht shqiptar, tërësisht të huaj, ose me kapital të përbashkët.

Neni 5

Bankat mund të hapin filiale, degë, agjenci ose zyra të tjera bankare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

Bankat që janë të licencuara sipas ligjit të një vendi të huaj mund të hapin filiale, degë, agjenci ose zyra të tjera banke në Republikën e Shqipërisë me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

Bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë mund të zgjerojnë a pakësojnë rrjetin e tyre (filiale, degë, agjenci ose zyra të tjera banke) në Republikën e Shqipërisë, pa autorizimin paraprak nga Banka e Shqipërisë.

Neni 6
**Ndalimet**

1. Asnjë subjekt nuk do të ushtrojë veprimtari bankare pa një licencë efektive të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

2. Asnjë institucion financiar nuk do të kryejë veprimtari bankare pa një licencë efektive, në qoftë se Banka e Shqipërisë vendos në bazë të nenit 1 se institucioni duhet të ketë një licencë.

3. Asnjë subjekt tjetër, përveç një banke, nuk do të pranojë depozita nga publiku, depozita pa afat dhe depozita me një afat fillestar maturimi 12-mujor ose më pak.

4. Asnjë subjekt nuk do të përdorë fjalën "bankë" ose derivate të fjalës "bankë" në lidhje me ushtrimin e një veprimtarie tregtare, prodhuese apo të shërbimit, pa një licencë efektive të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj ose në marrëveshjet ndërkombëtare.

5. Asnjë bankë e organizuar jashtë Republikës së Shqipërisë nuk do të lejohet të ushtrojë drejtpërsëdrejti veprimtarinë bankare në Republikën e Shqipërisë, përderisa kjo veprimtari të jetë

ndërmarrë nga një filial, degë, agjenci e saj, për të cilën është lëshuar një licencë efektive nga Banka e Shqipërisë.

6. Asnjë subjekt nuk do të keqinterpretojë faktet materiale apo përfaqësojë një mashtrim, të kryejë ndonjë veprim për të mashtruar, ose të ushtrojë praktika dhe veprime manipuluese në lidhje me pranimin e depozitave.

7. Asnjë bankë apo institucion financiar që kryen veprimtari bankare nuk do të angazhohet në veprimtarinë e marrjes së depozitave a të dhënies së kredisë, pa publikuar me shkrim normat e interesit, me bazë vjetore, për depozitat dhe kreditë.

## KREU II
## LICENCIMI

### Neni 7
### **Kompetenca e Bankës së Shqipërisë për të licencuar**

Banka e Shqipërisë është i vetmi autoritet për dhënien e licencave bankave dhe institucioneve të tjera që të kryejnë veprime bankare në Republikën e Shqipërisë.

### Neni 8
### **Kapitali minimal i kërkuar për bankat e reja**

1. Banka e Shqipërisë është i vetmi autoritet që ka kompetencë për caktimin e shumës së kapitalit minimal të kërkuar për bankat e reja të licencuara dhe ndryshimin e kësaj shume nga njëra periudhë në tjetrën me rregullore.

Kontributi në natyrë për kapitalin nuk mund të tejkalojë një të pestën e shumës së kapitalit minimal të kërkuar.

2. Sasia e kapitalit minimal të kërkuar do të përcaktojë veprimtaritë bankare që do të lejohen të kryhen nga banka sipas nenit 26.

### Neni 9
### **Kërkesa për licencë**

1. Kërkesa për licencë duhet të bëhet me shkrim në Bankën e Shqipërisë siç përcaktohet në rregulloren e Bankës së Shqipërisë. Kërkesa duhet të shoqërohet me këtë informacion bazë:

a) Kualifikimi dhe përvoja e administratorëve të bankës së propozuar, duke përfshirë të dhëna në fushën e veprimtarisë tregtare ose profesionale për dhjetë vjetët e fundit, si dhe emrat e personave rekomandues, me të cilët do të lidhet (kontaktojë) Banka e Shqipërisë, një deklaratë që asnjë nga faktorët skualifikues të nenit 21 nuk zbatohet për administratorët e ardhshëm.

b) Shumën e kapitalit të nënshkruar për bankën që kërkon të licencohet, shumën e kapitalit të paguar, si dhe çdo hua të marrë nga aksionarët e mundshëm për të paguar konributet e tyre të kapitalit.

c) Një plan të veprimtarisë bankare për bankën e propozuar që përcakton, ndër të tjera, strukturën organizative, llojet e veprimtarive financiare që mendohet të kryhen, si dhe raportet financiare të parashikuara për 3 vjetët pasardhës.

ç) Emri, rezidenca dhe të dhëna të veprimtarisë tregtare ose profesionale për dhjetë vjetët e fundit të çdo personi që propozon të disponojë 10 për qind ose më shumë të çdo grupi të aksioneve me të drejtë vote të bankës së propozuar, si dhe sasinë e aksioneve të propozuar.

Për qëllime të pikës "c" interesi i pronësisë i propozuar nga personat që kanë lidhje, do të mblidhen për të përcaktuar shumën e aksioneve të propozuar për disponim.

d) Nëse një bankë e huaj propozon të disponojë më shumë se 25 për qind të kapitalit të nënshkruar të një banke të re, banka e huaj duhet të jetë e autorizuar të kryejë veprime të pranimit të depozitave në para, ose fonde të tjera të kthyeshme në vendin e huaj ku kryen veprimtari drejtoria qendrore e saj. Autoritetet kompetente të huaja që mbikëqyrin veprimtaritë financiare të drejtorisë qendrore të bankës së huaj të interesuar, duhet të kenë dhënë pëlqimin e tyre me shkrim për dhënien e kësaj licence.

dh) Informacion shtesë për licencimin, do të përcaktohet në rregulloret e Bankës së

Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë ka të drejtë t'i kërkojë kërkuesit të licencës të paraqesë informacion shtesë ose plotësues për kërkesën e tij për licencë, nëse sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë informacioni bazë i paraqitur nuk është i plotë dhe i mjaftueshëm.

3. Kërkesa për licencim e degës së një banke të huaj do të bëhet nga banka e huaj. Kërkesa për një licencë të tillë do të shoqërohet me informacion të ngjashëm me atë të kërkuar në pikën 1 të këtij neni, si dhe informacion tjetër shtesë që Banka e Shqipërisë do të përcaktojë me rregullore.

Neni 10

**Vendimi për licencë**

1. Banka e Shqipërisë, brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës për licencë, kërkesë që është plotësuar (hartuar) sipas rregullores së nxjerrë nga Banka e Shqipërisë, jep miratimin paraprak ose refuzon licencën dhe njofton me shkrim kërkuesin për vendimin e saj. Vendimi për refuzimin e licencës duhet të shpjegojë edhe arsyet që çuan në këtë refuzim.

a) Arsyet për refuzimin e një kërkese mund të përmblidhen në atë që informacioni i parashtruar nga kërkuesi është, sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë, i pamjaftueshëm për të vendosur nëse kërkuesi plotëson kriteret e paragrafit "1.b" për miratimin e kërkesës.

b) Banka e Shqipërisë do të japë licencë vetëm nëse:

i) krijon bindjen që banka do t'u përmbahet dispozitave të këtij ligji.

ii) krijon bindjen se kualifikimet, përvoja dhe reputacioni i administratorëve të bankës dhe aksionarëve të saj me interesa të konsiderueshëm janë të përshtatshme për planin e veprimtarive tregtare dhe për veprimtaritë financiare për të cilat banka licensohet; dhe

iii) krijon bindjen për vërtetësinë e kapitalit dhe se gjendja e pritshme financiare e bankës së propozuar do të jetë e kënaqshme.

2.a) Në rastin e miratimit paraprak të kërkesës për licencë, Banka e Shqipërisë do të parashtrojë kushtet që duhet të plotësojë banka për të marrë licencë për të filluar veprimtarinë, për të cilën ajo autorizohet.

Kushtet për marrjen e licenës janë:

i) pagesa e kapitalit minimal të kërkuar nga themeluesit e bankës;

ii) marrja në punë të administratorëve të bankës;

iii) blerja ose marrja me qira e pajisjeve të punës;

iiii) blerja ose marrja me qira e lokaleve të bankës, dhe

iiiii) emërimi i një kontrollori të pavarur në përputhje me nenin 40.

b) Nëse banka brenda një viti nuk i plotëson kushtet për marrjen e licencës për fillimin e veprimtarisë, atëherë miratimi paraprak i kërkesës për licencë bëhet i pavlefshëm.

c) Nëse kushtet e pikës 2/a të këtij neni plotësohen, Banka e Shqipërisë jep menjëherë miratimin përfundimtar për licencë për bankën që do të fillojë veprimtarinë.

3. Licencat lidhur me një filial ose me një a më shumë degë të një banke të huaj do të jepen vetëm nëse Banka e Shqipërisë vendos që banka e huaj është e mbikëqyrur në mënyrë të mjaftueshme dhe në baza të qëndrueshme nga autoritete të huaja mbikëqyrëse.

Neni 11

**Efektet ligjore. Komisionet**

1. Licenca do të jepet e pakufizuar në kohë dhe nuk do të jetë e transferueshme.

2. a) Në vijim të licencimit fillestar bankat që besojnë se kapitali i tyre ka arritur shumën që do t'i lejonte ato të futen në veprimtari financiare shtesë, mund të kërkojnë në Bankën e Shqipërisë që të kryejnë të tilla operacione shtesë.

b) Nëse sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë kapitali i bankës ka arritur shumën e kërkuar, Banka e Shqipërisë do të autorizojë menjëherë bankën të hyjë në veprimtari financiare shtesë. Në të kundërtën Banka e Shqipërisë nuk do ta miratojë këtë kërkesë dhe për pasojë do të japë me shkrim arsyet.

3. Banka e Shqipërisë mund të vendosë komisione për:

i) përpunimin e kërkesës për licencë;

ii) dhënien e licencës , dhe

iii) posedimin e licencës.

Komisione të tilla nuk kthehen në rastet kur kërkesa për licencë nuk miratohet ose banka nuk fillon a ndalon veprimtarinë.

Neni 12

**Regjistrimi i bankave. Publiciteti**

1. Banka e Shqipërisë do të mbajë një regjistër qendror për inspektim nga ana e publikut, ku do të regjistrohen për secilën bankë të licencuar emri, adresat e drejtorisë qendrore dhe degëve, si dhe kopjet aktuale të dokumenteve të paraqitura në nenin 18.

2. Një kopje e këtij regjistri do të mbahet për inspektim publik në çdo filial të Bankës së Shqipërisë.

3. Dokumentet që kanë të bëjnë me ish - bankat, licencat e të cilave janë revokuar, hiqen nga regjistri. Një listë e këtyre bankave mbahet në regjistër.

4. Kur jepet një licencë, Banka e Shqipërisë do të publikojë një njoftim në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në disa nga gazetat më të qarkullueshme.

Neni 13

**Revokimi i një licence**

1. Licenca e një banke apo institucioni financiar që kryen veprimtari bankare mund të revokohet vetëm me vendim të Bankës së Shqipërisë:

i) me kërkesë të vetë bankës ose të institucionit financiar të licencuar, që kryen veprimtari bankare;

ii) në vijim të shkeljeve sipas nenit 45, ose

iii) për një a më shumë nga arsyet e mëposhtme:

a) licenca është siguruar në bazë të informacionit jo të vërtetë të dhënë nga kërkuesi dhe që ka të bëjë me kërkuesin, duke përfshirë çështjet që kanë lidhje me kualifikimet, përvojën ose reputacionin e administratorëve dhe aksionarëve të propozuar me interesa të konsiderueshëm, ose parregullsi të tjera materiale të shkaktuara në lidhje me kërkesën për licencë;

b) banka nuk ka filluar veprimtarinë brenda 12 muajve pas marrjes së licencës ose ka ndërprerë për më shumë se 6 muaj pranimin e depozitave të transferueshme apo fonde të tjera të kthyeshme;

c) një banke tjetër që posedon pjesë të konsiderueshme të kapitalit në bankë i është hequr licenca;

d) ka ndodhur një bashkim, shkrirje ose shitje e pothuaj gjithë aktiveve të bankës;

e) disponuesi i pjesës së konsiderueshme të kapitalit në bankë ka transferuar ose ka humbur këtë disponim, pa pasur lejen me shkrim të Bankës së Shqipërisë;

f) pronari ose pronarët e bankës kanë vendosur të shpërndajnë a likujdojnë bankën, ose banka ka pushuar së ekzistuari si subjekt ligjor apo i pavarur;

g) veprimtaritë e bankës gjatë 3 viteve të parë të punës ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ato të paraqitura në kërkesën për licencë dhe, sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë, një shmangie e tillë nuk përligjet nga ndryshimet në rrethanat ekonomike.

2. Kur një bankë kërkon që Banka e Shqipërisë t‘i revokojë asaj licencën, Banka e Shqipërisë do të vendosë brenda 30 ditësh pas marrjes së kërkesës.

3. Licenca që i është dhënë një banke të huaj në lidhje me një ose më shumë degë të saj, do të revokohet nga Banka e Shqipërisë nëse banka e huaj nuk ka ose ka humbur autoritetin për të kryer operacionet e pranimit të depozitave në para apo fonde të tjera të kthyeshme, në vendin e huaj ku është vendosur drejtoria qendrore e saj.

4. Vendimi i Bankës së Shqipërisë për të revokuar ose jo licencën do t‘i komunikohet menjëherë me shkrim bankës ose degës përkatëse dhe do të jepen arsyet për vendimin.

Neni 14
**Publikimi dhe efektet e revokimit të licencës**

1. Vendimi për të revokuar licencën në zbatim të nenit 13 ose 45 menjëherë do të publikohet në Fletoren Zyrtare dhe në një a në më shumë gazeta të qarkullueshme, kudo ku janë lokalizuar zyrat e bankës në fjalë. Vendimi për të revokuar licencën do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, ose në datën që përcakton vendimi i Bankës së Shqipërisë.

2. Në bazë të nenit 13 e 14 të këtij ligji, pas hyrjes në fuqi të revokimit të licencës, banka ndalohet të kryejë çdo veprimtari financiare dhe do të likujdojë sa më parë që të jetë e mundur aktivet e saj, t'i japë fund marrëveshjeve për depozitat pa afat dhe të shlyejë detyrimet e saj. Gjatë kohës së likujdimit banka do të vazhdojë të jetë subjekt i dispozitave të këtij ligji, njësoj sikur të ishte e licencuar.

KREU III
ADMINISTRIMI DHE PRONËSIA

Neni 15
**Drejtimi i bankave**

Bankat, në organizimin e tyre si shoqëri tregtare anonime, nuk do të kenë këshill mbikëqyrës. Neni 96, fjalia e parë e nenit 97 dhe nëndarja II e pjesës IV të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", nuk zbatohet për bankat.

Në nenin 98 të ligjit "Për shoqëritë tregtare" termi "këshilli mbikëqyrës" do të zëvendësohet me termin "asamble e përgjithshme e aksionarëve". Në nenin 136 paragrafi i parë i pikës katër termi "këshilli mbikëqyrës" zëvendësohet me termin "këshilli i drejtuesve" dhe çdo përgjegjësi tjetër e këtij këshilli sipas ligjit "Për shoqëritë tregtare" do të jetë përgjegjësi e këshillit të drejtuesve.

Neni 16
**Organizimi dhe pavarësia e bankave**

1. Bankat do të organizohen sipas ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" si shoqëri tregtare anonime ose si banka kooperative, sipas nenit 58 të këtij ligji.

2. Secila bankë do të gëzojë pavarësi të plotë ligjore, operacionale, financiare dhe administrative, nga çdo subjekt tjetër, duke përfshirë Bankën e Shqipërisë dhe çdo agjenci, ose nëndarje politike të qeverisë, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj. Kjo pavarësi do të respektohet dhe asnjë subjekt nuk do të kërkojë të ndikojë tek administratori i ndonjë banke për kryerjen e detyrave të tij apo të saj, ose të ndërhyjë në veprimtaritë e ndonjë banke për kryejen e detyrave të tij apo të saj, përveç rasteve të ekzekutimit urdhrit të një autoriteti të veçantë ose të një detyre të dhënë sipas ligjit.

Neni 17
**Struktura administrative e bankave**

Banka drejtohet nga këshilli i drejtuesve, si organi përgjegjës, vendimmarrës dhe mbikëqyrës, dhe do të ketë një komitet kontrolli.

Kompetencat e këshillit të drejtuesve dhe të komitetit të kontrollit përcaktohen në "Statut". " Statuti" i bankës dhe çdo ndryshim i tij miratohen nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve.

Neni 18
**Rregullore e brendshme**

Banka drejtohet e udhëhiqet nga rregulloret e brendshme të miratuara nga këshilli i drejtuesve, të cilat duhet të jenë në përputhje me "Statutin" e saj dhe duhet të përcaktojnë:

a) Strukturën e organizimit dhe të administrimit të bankës , duke përfshirë edhe njësitë e saj funksionale dhe administrative, në njësitë dhe funksionet e tyre, pozicionet mbikëqyrëse dhe

marrëdhëniet raportuese.

b) detyrat e çdo drejtori të departamentit dhe të njësive që ai drejton e mbikëqr;

c) funksionet e komitetit të kontrollit dhe të komiteteve të tjera të brendëshme të përhershme;

d) kufijtë e kompetencave të administratorëve dhe të punonjësve të tjerë të bankës që do të kryejnë veprimtari financiare në emër dhe për llogari të bankës.

Neni 19

**Këshilli i drejtuesve**

1. Këshilli i drejtuesve të bankës është përgjegjës për hartimin e politikave dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së bankës.

2. Këshilli i drejtuesve të bankës duhet të përbëhet prej një numri tek anëtarësh, jo më pak se pesë. Anëtarët e këshillit caktohen nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve të bankës për një periudhë jo më të madhe se katërvjeçare. Ata mund të zgjidhen për periudhat vijuese katërvjeçare.

Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve të një banke mund të vendosë dhënie shpërblimi për anëtarët e këshillit të drejtuesve dhe të komitetit të kontrollit.

Neni 20

**Komiteti i kontrollit**

1. Komiteti i kontrollit përbëhet nga tre anëtarë që emërohen nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve dhe ka këto detyra:

a) përcakton dhe mbikëqyr procedurat llogaritëse të bankës dhe kontrollon llogaritë dhe regjistrimet e saj;

b) kontrollon zbatimin e rregullave dhe i raporton këshillit të drejtuesve të bankës;

c) jep mendime për të gjitha problemet që i kërkohen nga këshilli i drejtuesve të bankës.

2. Komiteti i kontrollit mblidhet një herë në tre muaj dhe në mbledhje të jashtëzakonshme, kur thirret nga këshilli i drejtueve të bankës. Vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Abstenime nuk lejohen.

3. Me kërkesën e tij komiteti i kontrollit ndihmohet nga ekspertë që emërohen nga këshilli i drejtuesve të bankës.

Neni 21

**Cilësia e administratorëve**

1. Të gjithë personat e zgjedhur ose të emëruar si administratorë të një banke ose institucioni financiar që kryen veprimtari bankare duhet të kenë reputacion të mirë dhe të përmbushin kriteret e vëna në rregulloren e Bankës së Shqipërisë në lidhje me kualifikimet, përvojën dhe reputacionin.

2. Një person nuk mund të jetë i përshtatshëm për t'u bërë anëtar i këshillit të drejtuesve të një banke, ose me vendim të mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve lirohet nga anëtarësia në këshillin e drejtuesve të bankës, në rastet kur:

a) është anëtar i këshillit të drejtuesve të një banke tjetër;

b) me ligj i është hequr e drejta të jetë në këshillin e drejtuesve të një shoqërie tregtare të organizuar sipas ligjit "Për shoqëritë tregtare";

c) Ai shërben ose ka shërbyer gjatë periudhës 12-mujore paraardhëse në këshillin e drejtuesve të Bankës së Shqipërisë;

d) është shpallur fajtor nga gjykata për një vepër që ka të bëjë me figurën morale, ose

e) ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese të detyrimeve dhe nuk është çliruar ende nga pagesat e detyrimeve të shkuara.

3. Këshilli i drejtuesve të Bankës ose i institucionit financiar që kryen veprime bankare dhe anëtarët e tij nuk mund të delegojnë detyrat e tyre te të tjerët.

Neni 22

**Kapitali i detyrueshëm**

Bankat do të mbajnë një kapital të detyrueshëm për të përballuar rreziqet. Kapitali i detyrueshëm i bankës shprehet me normë në përqindje ndaj aktiveve me rrezik, që përcaktohen me rregullore nga Banka e Shqipërisë.

Neni 23

**Detyrimi për të ruajtur sekretin dhe besimin**

1. Administratorët, nëpunësit dhe agjentët aktualë e të mëparshëm të një banke, si dhe personat e tjerë që ngarkohen për kontrollin e veprimtarisë bankare, duhet të ruajnë sekretin e çdo informacioni që marrin gjatë punës së tyre në bankë dhe të mos e përdorin atë për përfitime personale apo për të tretë.

2. Informacioni i përshkruar në pikën 1 mund t'i jepet vetëm Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë inspektorët e saj dhe kontrollorët e emëruar prej saj, kontrollorëve të jashtëm të bankës, autoriteteve të tjera administrative e juridike që e fitojnë këtë të drejtë me ligj, si dhe kur e kërkon mbrojtja e interesave të bankës në procedurat ligjore.

3. Bankat duhet të përgatitin procedura e rregulla të përshtatshme, në mënyrë që ato , administratorët dhe nëpunësit e bankës të mos vihen në një situatë ku detyrat e tyre kundrejt një klienti bien në kundërshtim me detyrën e tyre ndaj një tjetri, ose kur vetë interesat e tyre bien në konflikt me detyrën ndaj klientit.

Neni 24

**Pastrimi i parave**

1. Banka ndalohet të fshehë, të konvertojë ose të transferojë para a pasuri tjetër, kur ajo ka dijeni se një pasuri e tillë buron nga një veprimtari kriminale, që ka për qëllim fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të pasurisë, ose ka për qëllim të ndihmojë ndonjë person që angazhohet në një veprimtari të tillë për t'iu shmangur pasojave ligjore të veprimit të tij.

2. Të pasurit dijeni për sa përshkruhet në pikën 1 mund të konkludohet nga rrethanat objektive të faktit.

3. Pa marrë parasysh nenin 23, bankat duhet me nismën e tyre të informojnë autoritetet që janë përgjegjëse për luftën kundër pastrimit të parave me të dhëna për pasurinë, ose prejardhjen e saj, që buron nga veprimtari kriminale, dhe të japin me kërkesën e autoriteteve çdo informacion shtesë përkatës, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 25

**Deklarimi i konflikteve të interesit, detyrimi i besimit**

1. Administratori i bankës deklaron me shkrim në bankë natyrën dhe shkallën e interesit ose marrëdhënieve me përfitim material kur:

i) është palë në një kontratë me përfitim material të propozuar me bankën, ose

ii) përfiton materialisht nga një marrëveshje me çdo subjekt, i cili është palë në një kontratë me përfitim material të lidhur me bankën.

2. Deklarimi i kërkuar në pikën 1 bëhet nga administratori, kur ai është në dijeni se kontrata ose propozimi vjen ose duhet të vijë në mënyrë të arsyeshme.

3.a) Deklarimi i interesave prej çdo administratori do të bëhet me një njoftim të përgjithshëm me shkrim në këshillin e drejtuesve të bankës herë pas here, por jo më rrallë se një herë në vit.

b) Njoftimi duhet të përmbajë emrat dhe adresat e ortakëve të administratorit dhe detaje të plota të arsyeshme të çdo veprimtarie me përfitim material, tregtar, financiar, bujqësor, industrial ose të çdo lloji interesi tjetër familjar, që ky person ka gjatë kësaj periudhe.

c) Administratori duhet të deklarojë edhe interesat materiale në çdo kontratë ndërmjet bankës dhe çdo personi të përmendur në deklaratë.

4. Administratori që ka interes për përfitim material ose përfitim material brenda kuadrit të paragrafëve 1 ose 3, nuk merr pjesë në mbledhje gjatë diskutimit të kontratës dhe nuk ka të drejtë vote për çdo çështje që ka lidhje me këtë e që bëhet subjekt vendimi nga këshilli i drejtuesve të bankës, pavarësisht se një interes i tillë, nëse deklarohet, nuk e skualifikon personin në fjalë për qëllime të

plotësimit të numrit të domosdoshëm për efekt vlefshmërie të votimit.

5. Për qëllime të pikave 1 dhe 3 një interes do të jetë me përfitim material, nëse materializohet me pasurinë, veprimtarinë tregtare ose familiare (çdo person që lidhet me martesë ose me gjak, deri në brez të dytë) të personit që ka interes.

Një person ka interes për përfitim material kur:

i) personi është pronar drejtpërdrejt ose tërthorazi i çdo shoqërie tregtare ku ka interesa të konsiderueshme ose në çdo shoqëri tregtare që është administrator i saj; ose

ii) në çdo ortakëri nëse personi është ortak.

6. Kur një administrator nuk deklaron konfliktet me përfitim material , sipas këtij neni:

a) Gjykata e juridiksionit përkatës, me kërkesë të bankës, të një aksionari, ose të Bankës së Shqipërisë, mund ta mënjanojë kontratën për arsye që ajo e quan të përshtatshme dhe

b) Banka e Shqipërisë me urdher me shkrim, mund të pezullojë administratorin për një periudhë deri në një vit, ose ta lëvizë administratorin përgjithmonë.

7. Pavarësisht nga detyrimit ndaj bankave sipas nenit 23, administratorët e bankave kanë një detyrë ndaj bankës që ata i shërbejnë dhe ndaj klientëve të bankës, për të vënë interesat e bankës dhe interesat e klientëve të saj mbi interesat e veta.

## KREU IV
## RREGULLA PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE VEPRIMTARITË E LEJUESHME PËR BANKAT

### Neni 26

1. Bankat në licencën e tyre do të autorizohen të kryejnëveprimtaritë financiare të përshkruara në pikën 3 të këtij neni.

Bankat me kapital të rritur, përveç veprimtarive të përshkruara në pikën 3 mund të kryejnë edhe veprimtaritë e përshkruara në pikën 4 dhe 5 të këtij neni në këto kushte:

a) Bankat që fillojnë veprimtarinë me kapital nga minimumi i kërkuar për marrjen e licencës deri në dyfishimin e këtij minimumi në përputhje me rregullat e nxjerra nga Banka e Shqipërisë, që modifikohet kohë pas kohe, mund të kryejnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në pikën 3.

b) Bankat që fillojnë veprimtarinë me një kapital nga dy- trefishi i shumës minimale të kapitalit të kërkuar, në përputhje me rregullat e Bankës së Shqipërisë, të modifikuara kohë pas kohe, mund të kryejnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni.

c) Bankat që fillojnë veprimtarinë me një kapital më të madh se trefishi i shumës minimale të kapitalit të kërkuar, mund të kryejnë veprimtaritë financiare të pikave 3, 4 dhe5 të këtij neni.

2. Asnjë bankë nuk lejohet të kryejë veprimtari financiare që janë jashtë atyre të lejuara shprehimisht në licencën e saj.

3. Në përputhje me licencën e marrë bankat kanë të drejtë:

a) Pranimin e depozitave (në formën e depozitave pa afat, depozitave me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilat paguan ose jo interes.

b) Dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun me ose pa burime ndihme dhe financimin e transaksioneve tregtare.

c) Marrje hua të fondeve dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve:

i) të instrumenteve të tregut monetar (duke përfshirë, ndër të tjera, çeqet, kambialet dhe certifikatat e depozitave);

ii) të letrave me vlerë të borxhit;

iii) të kontratave të “së ardhmes” dhe kontratat "e mundësive", që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose normat e interesit;

iiii) të instrumenteve të normës së interesit.

d) Kryerjen e shërbimeve të pagesës.

e) Emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesës (duke përfshirë ndër të tjera, pagesat me kartë, me çeqet e udhëtarit dhe çeqet e bankierit).

f) Ndërmjetësin për operacione monetare (duke përfshirë valutat).

g) Lisingu financitar.

h) Kryerjen e shërbimeve si agjent financiar, ose këshilltar financiar (jo për shërbime të përshkruara në pikën 3/a dhe 3/b).

j) Kyerjen e veprimtari të tjera financiare që do të përcaktohen në rregullore të Bankës së Shqipërisë.

4. Bankat kanë të drejtë të bëjnë këmbimin e valutave, duke përfshirë kontrata të së ardhmes për këmbime valutore.

5. Bankat në përputhje me licencën e marrë kryejnë edhe këto shërbime:

a) shërbimin e besimit, duke përfshirë pa kufizim, investimin dhe administrimin e fondeve të marra në mirëbesim;

b) shërbimin si administrues i portofolit të investimit ose këshilltarit për investimet;

c) nënshkrimin dhe shpërndarjen e letrave me vlerë të borxhit e të pronësisë, si dhe tregtimin e letrave me vlerë të pronësisë.

6. Banka apo institucioni financiar që kryen veprimtari bankare nuk mund të hyjë drejtpërdrejtë në veprimtari industriale e tregtare, ose të kryejë shërbime që nuk janë shërbime bankare.

Neni 27

Banka kryen veprimtarinë e saj sipas parimit të shmangies së rrezikut, në pajtim me format e pagesave dhe rregullat e udhëzimet e Bankës së Shqipërisë.

Neni 28

1. Banka për çdo veprim krediti mban këto veprime ligjore:

a) Aktkredinë, dokumentet që tregojnë përdorimin e saj, statusin ligjor dhe vlerën e pranuar e të nënshkruar të garancive të kërkuara e të paraqitura.

b) Regjistrimin financiar të klientit e të çdo garantuesi, që shërben si bazë për miratimin e veprimeve të transaksioneve të kredisë.

c) Vendimin që miraton veprimet e kredisë, nënshkruar nga personat përgjegjës. Në raste të veçanta, kur vendimi merret nga këshilli i drejtuesve të bankës, nxirret një kopje e ekstraktit të protokollit të mbledhjes, ku është miratuar veprimi i kredisë.

2. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë dokumente e procedura plotësuese tej kushteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 29

**Dokumentacioni**

1. Banka përgatit dhe mban në drejtorinë qendrore të saj këtë dokumentacion:

a) Statutin e saj dhe rregulloret e brendshme me të gjitha amendamentet e tyre.

b) Regjistrin e aksionarëve të saj, duke përfshirë numrin e aksioneve të regjistuara në emër të çdo aksionari.

c) Protokollin e mbledhjeve dhe vendimet e këshillit të drejtuesve, dhe

d) Protokollin e mbledhjeve dhe vendimet e aksionarëve.

2. Banka a institucioni financiar i licencuar që kryen veprimtari bankare do të përgatitë dhe mbajë në drejtorinë qendrore të tij këtë dokumentacion:

a) Dokumentacionin kontabël që pasqyron qartë e në mënyrë korrekte gjendjen e veprimtarisë së tij financiare, duke shpjeguar transaksionet dhe pozicionin financiar, në mënyrë që t'i krijojë Bankës së Shqipërisë mundësitë për të përcaktuar nëse institucioni vepron në përputhje me të gjitha dispozitat e këtij ligji.

b) Dokumentacionin që tregon, për çdo klient të bankës ose të institucionit financiar që kryen veprimtari bankare, hollësitë e transaksioneve të tij, në bazë ditore me ose për llogari të këtij klienti dhe bilancin e të drejtave ose detyrimeve ndaj klientit, si dhe

c) Çdo dokument tjetër që parashikohet si i domosdoshëm nga ky ligj ose nga rregullat a urdhrat e Bankës së Shqipërisë.

Neni 30

Banka detyrohet të respektojë kufijtë e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë si vijon:

a) raportet maksimale që duhet të ruhen ndërmjet mjeteve të saj, mjeteve të dhëna me rrezik e zërave jashtë bilancit dhe kapitalit të saj, rezervës dhe fitimit;

b) shumën maksimale të kredisë të shprehur në përqindje ndaj kapitalit të saj, rezervës dhe fitimit, që banka lejohet t'i japë çdo huamarrësi të vetëm ose grupi huamarrësish solidarë;

c) nivelin e shumës maksimale të kredisë, të shprehur në përqindje ndaj shumës së dhënë dhe të pakthyer, që banka lejohet t'ua japë dhjetë huamarrësve më të mëdhej të saj, duke përfshirë edhe grupet e huamarrësve solidarë.

Neni 31

Bankat detyrohen të zbatojnë kërkesat e caktuara nga Banka e Shqipërisë për:

a) madhësinë minimale të rezervave likuide ose të kategorive të veçanta të këtyre rezervave, në varësi nga masa ose ndryshimi i masës së mjeteve, garancive ose të kategorive specifike të tyre, apo në varësi nga masa ose ndryshimi i madhësisë së detyrimeve apo kategorive specifike të tyre, me kusht që banka të plotësojë kërkesën e rezervave likuide, duke mbajtur depozita me një vlerë të barasvlershme pranë Bankës së Shqipërisë;

b) shumën maksimale të kredive, të investimeve financiare dhe të garancive ose të kategorive të tjera specifike;

c) shumat që duhet të rezervohen kundrejt huave me probleme dhe pa shpresë arkëtimi;

d) ndalimet, kufizimet dhe kushtet për:

- llojet ose format e kredive e të investimeve financiare, ose tërësinë e detyrimeve që lidhen me to;
- kontrollin e maturimit të mjeteve e të detyrimeve dhe të zërave jashtë bilancit;
- pozicionet e pambuluara të monedhës së huaj.

Një bankë nuk mund të bëjë shpërndarje kapitali, në qoftë se sipas Bankës së Shqipërisë, pas shpërndarjes, bankës do t'i mbetet më pak se kapitali minimal i detyrueshëm.

Neni 32

Banka detyrohet t'u bëjë të njohur rregullisht klientëve të saj të dhënat për kushtet e përqindjet e interesit vjetor, që lidhen me depozitat, dhënien e kredisë dhe ndryshimet e tyre, duke përfshirë dhe mënyrën e llogaritjes.

Neni 33

Bankat, pa autorizimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë nuk kryejnë veprimtaritë e mëposhtme për:

a) pakësimin e kapitalit të tyre nëpërmjet riblerjes së aksioneve ose shpërndarjes së mjeteve rezervë;

b) blerjen e aksioneve ose bërjen pjesëtar në to të një shume më të lartë se 10 për qind të kapitalit të shoqërive tregtare ose të vënies në pronësi të përbashkët, apo të bashkimit me subjekte të tjera, përveç bankave a institucioneve të këtij lloji që përcaktohen nga Banka e Shqipërisë.

c) për dhënien e lejes për investimet e përshkruara në shkronjën "b" të këtij neni deri në 75 për qind të kapitalit themelor, të rezervave dhe të fitimit të saj.

Neni 34

1. Kufizimet sipas nenit 33 të këtij ligji nuk zbatohen për këto raste:

a) blerjen e aksioneve ose vlerave të tjera kundrejt shlyerjes së kredive të dhëna. Në këtë rast banka blerëse disponon të gjitha aksionet ose vlerat e marra për një vit, derisa të jepet zgjatje e huasë nga Banka e Shqipërisë.

b) Blerja e aksioneve ose e vlerave të tjera si një agjent.

c) Blerja e aksioneve me qëllim rishitje të tyre të tretëve.

2. Banka ndalohet të bëjë kontrata, marrëveshje a të miratojë praktika të çfarëdo lloji,

nëpërmjet të cilave siguron pozitë dominuese mbi paratë, tregjet valutore e financiare. Nuk lejohet pjesëmarrja në praktika manipuluese për të ruajtur avantazhe të padrejta për vete ose për të tretët.

## KREU V
## MARRËDHËNIET E BANKËS ME PERSONA TË LIDHUR ME TË

### Neni 35

1. Banka kryen veprime me persona të lidhur me të, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Në kuptim të këtij ligji termi "person i lidhur me të" është:

a) secili nga administratorët të përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji;

b) çdo shoqëri ose ndonjë nga administratorët dhe aksionistët kryesorë të kësaj shoqërie që kontrollon bankën;

c) bashkëshortja ose ndonjë nga të afërmit, deri në brezin e tretë të ndonjërit nga administratorët e bankës, ose ndonjë nga administratorët kryesorë të ndonjë shoqërie që kontrollon bankën;

ç) çdo shoqëri, në të cilën ndonjë nga personat e mësipërm zotëron ose jo drejtpërdrejt më shumë se 10 për qind të kapitalit;

d) ndonjë nga aksionarët kryesorë të bankës dhe të ndonjë shoqërie tregtare nën kontrollin e drejtpërdrejtë të tyre;

e) person juridik a fizik që zotëron një bankë dhe administratorët e tij, si dhe çdo ent ligjor që zotërohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt prej tyre dhe administratorët e tyre;

f) personat e lidhur me çdo institucion financiar që përbën një grup institucionesh financiare të ndërlidhura, konsiderohen si persona të lidhur me secilin nga institucionet e këtij grupi.

### Neni 36

Në kuptim të nenit 35:

a) "Aksionar kryesor" kuptohet pronari që zotëron më shumë se 10 për qind të kapitalit themeltar të paguar të një shoqërie tregtare.

b) "Kontroll" në lidhje me një shoqëri ose bankë kuptohet:

- të zotërosh më shumë se 50 për qind të aksioneve;
- të kesh pushtet për të zgjedhur pjesën më të madhe të administratorëve të shoqërisë tregtare;
- të kesh ndikim në përcaktimin e politikës së drejtimit të shoqërisë tregtare ose bankës.

### Neni 37

Banka nuk jep kushte favorizuese për personat e lidhur me të.

Në kuptim të këtij neni "kushte favorizuese" quhen:

a) veprime që nga natyra, qëllimi dhe rreziku që kanë nuk kryhen për klientët e tjerë, por kryhen për persona të lidhur;

b) interesi, komisionet bankare, detyrime të tjera dhe pranimi i garancive që janë më të ulëta se sa ato të klientëve të tjerë.

### Neni 38

Banka u jep kredi "personave të lidhur me të" në kuptim të nenit 35 të këtij ligji, me vendim të këshillit të drejtuesve të bankës, të bazuar në një raport të drejtorisë përkatëse. Raporti përshkruan marrëdhënie të personit të lidhur me të për veprimin që do të bëhet, gjendjen financiare të kërkuesit dhe vlerësimin e kredibilitetit të tij.

Anëtari i këshillit të drejtuesve të bankës largohet nga mbledhja gjatë kohës kur këshilli diskuton dhe vendos për veprime që kanë lidhje me të ose një person tjetër, me të cilin anëtari i këshillit ka lidhje martesore, gjaku, farefisnie apo interesa fitimi.

Masa e kredisë që do t'i jepet nga banka punonjësit të saj, përcaktohet nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve. Shuma e kredisë së dhënë nga banka punonjësve të saj nuk do të kalojë 10

për qind të kapitalit të saj.

## KREU VI
## LLOGARITË, KONTROLLI, INSPEKTIMI DHE MËNYRA E RAPORTIMIT

### Neni 39

Banka mban llogaritë e nevojshme dhe përgatit raportet financiare, për të pasqyruar saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat llogaritëse gjendjen e saj financiare.

Kur banka merr pjesë me më shumë se 50 për qind të kapitalit të themeltar të paguar të saj në një a më shumë banka të tjera, ajo mban llogaritë e nevojshme dhe përgatit raportet financiare, për të pasqyruar saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat llogaritëse të njësuara, gjendjen financiare edhe të këtyre bankave.

Llogaritë dhe nxjerrjet financiare duhet të jenë në formë dhe përmbajtje të tillë dhe në përputhje me ato standarde kontabël që caktohen në rregulloret e Bankës të Shqipërisë, duke respektuar përgatitjen dhe paraqitjen e llogarive të bankës ose institucionit financiar, që kryen veprimtari bankare duke përfshirë krijimin e fondeve rezervë të përshtatshme për aktive të këqija e të dyshimta dhe për njohjen dhe përcaktimin e afatit të arkëtimit të të ardhurave.

### Neni 40

Banka cakton një kontrollor të pavarur të jashtëm, i cili miratohet nga Banka e Shqipërisë. Kontrollori ka këto detyra:

a) kontrollon në mbajtjen e llogarive, regjistrimin e operacioneve dhe të veprimeve të bankës, në përputhje me rregullat kontabël;

b) në përputhje me rregullat përkatëse përgatit raportin vjetor për gjendjen financiare (bilancin, llogarinë, fitime e humbje dhe dokumente të tjera të këtij lloji) të bankës dhe jep mendime për vërtetësinë e gjendjen financiare të bankës;

c) informon këshillin e drejtuesve të bankës, mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve dhe Bankën e Shqipërisë për çdo parregullsi a të metë të vëzhguar gjatë operacioneve, veprimeve, procedurave, regjistrimeve ose llogarive të bankës që mund t'i sjellin asaj humbje materiale;

d) rishqyrton përpikërinë e revizionit të brendshëm, kontrollon praktikat dhe procedurat dhe bën rekomandime për përmirësime.

### Neni 41

Bilanci i bankës, raporti vjetor dhe raporti i kontrollorit të jashtëm për vitin financiar botohen në buletinin zyrtar të bankës.

### Neni 42

Banka është objekt i kontrollit nga inspektorët e Bankës së Shqipërisë dhe nga kontrollori i pavarur i caktuar prej saj. Në kontrollin ndaj bankave, Banka e Shqipërisë dhe drejtoritë e kontrollit mund:

a) të shqyrtojnë llogaritë dhe dokumentacionin e duhur, librat dhe çdo dokument tjetër në arkivat e bankës;

b) të kërkojnë nga administratorët, nëpunësit dhe agjentët e bankës të japin informacione për çështje që lidhen me drejtimin dhe operacionet, siç do ta kërkojnë ata.

### Neni 43

Dispozitat e neneve 41 deri 42 të këtij ligji zbatohen edhe për degët dhe bankat e institucioneve të huaja financiare, që kryejnë veprimtari bankare.

Bilancet dhe raportet financiare të këtyre degëve mund të përgatiten në mënyrë të veçantë, sipas parimeve të përgjithshme të kontabilitetit.

Një organ përfaqësues i institucionit të huaj financiar mund të funksionojë si një komitet kontrolli për këto degë, për zbatimin e këtij ligji.

Neni 44

Banka përgatit raporte periodike sipas rregullave të caktuara nga Banka e Shqipërisë, duke dhënë informacion të nevojshëm për administrimin dhe operacionet e saj, likuditetet dhe fitimin.

## KREU VII
## SHKELJET DHE DËNIMET

Neni 45

Banka e Shqipërisë kur vëren se një bankë apo një institucion financiar që ushtron veprimtari bankare a ndonjë prej pronarëve ose administratorëve të tij është fajtor për:

i) shkeljen e një dispozite të këtij ligji apo të çdo rrregulli a urdhri të Bankës së Shqipërisë;

ii) shkeljen e çdo kushti a kufizimi që i bashkëngjitet një autorizimi të lëshuar nga Banka e Shqipërisë për një institucion;

iii) shkeljen e një detyre të besuar; ose

iiii) veprimntarinë jo të sigurt dhe jo të qëndrueshme të institucionit a degëve të tij.

Për shkeljet e vërejtura sipas paragrafit të parë të këtij neni pikat i, ii, iii dhe iiii Banka e Shqipërisë vendos për rregullimin e gjendjes duke marrë këto masa:

a) jep paralajmërime me shkrim për kufizimin e veprimeve të ndryshme bankare deri në heqjen e licencës;

b) cakton detyra për bankën që të marrë masa përmirësuese, duke përfshirë edhe ato që kufizojnë operacione të bankës;

c) lëshon urdhër me shkrim për ndalimin dhe shmangien e shkeljeve;

ç) organizon mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve ose pronarëve të tjerë të bankës, për të diskutuar masat e nevojshme që duhen marrë;

d) vendos për drejtimin e bankës me kujdestari, me anë të personave të autorizuar prej saj, të cilët veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

dh) revokon licencën e bankës;

e) pezullon përkohësisht ose largon administratorët e institucionit financiar që kryen veprimtari bankare nga vendi i punës.

Neni 46

Administratorët e Bankës së Shqipërisë, për shkeljet e rregullave të përcaktuara në nenin 13, pika 1, shkronja “a”, nenin 28, nenin 29, pika 1/c, d dhe pika 2/a, b, nenet 30, 31, 32, 33, 34 pika 2, nenet 37, 38 paragrafi i fundit, neni 39 dhe 44 të këtij ligji, kur ato nuk përbëjnë vepër penale, dënojnë për kundërvajtje administrative administratorët e bankës nga 5 deri në 10 paga mujore, si dhe për bankat ose institucionet e tjera financiare që kryejnë veprimtari bankare deri në 10 milionë lekë.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim te governatori i Bankës së Shqipërisë, brenda 5 ditëve punë nga shpallja ose njoftimi i tij, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

Neni 47

Dënimet administrative dhe masat që jepen, nuk pengojnë marrjen e masave civile a penale që përcaktohen në dispozitat ligjore.

Dënimet jepen në përputhje me rëndësinë e shkeljes dhe të dëmit të shkaktuar. Këto dënime zbatohen edhe për individët ose entet ligjore që kryejnë veprime bankare pa licencë.

Neni 48

Gjobat e vendosura arkëtohen për llogari të buxhetit të shtetit.

KREU VIII
KUJDESTARIA DHE LIKUIDIMI

Neni 49
**Bazat për ndërhyrje nga Banka e Shqipërisë**

Banka e Shqipërisë emëron një kujdestar ose administrator falimentimi për të marrë në dorë e kontrolluar një bankë ose institucion tjetër financiar, që ushtron veprimtari bankare sa herë që sheh se ekzistojnë një ose më tepër nga rrethanat e mëposhtme:

i) Ka shkelje të akteve ligjore ose nënligjore, ose ekziston një gjendje a praktikë e pasigurt ose e parregullt, e cila ka të ngjarë të shkaktojë paaftësi paguese ose shpenzime të kota të konsiderueshme të aktiveve a të ardhurave ose, nga ana tjetër, ka të ngjarë të dëmtojë seriozisht interesat e dispozituesve.

Në paragrafin "i" me “paaftësi paguese” do të kuptojmë:

a) Banka ose institucioni financiar që kryen veprimtari bankare ka të ngjarë të mos jetë i aftë të plotësojë kërkesat e depozituesve të tij a të paguajë detyrimet e tij gjatë veprimtarisë normale, ose

b) banka ose institucioni financiar që kryen veprimtari bankare ka shkaktuar a ka të ngjarë të shkaktojë humbje që do të harxhojë gjithë ose pothuajse gjithë kapitalin e tij rregullator.

ii) Banka ose institucioni financiar që kryen veprimtari bankare ka asgjësuar libra, dokumente, regjistrime ose aktive të insitucionit, apo ka refuzuar të paraqesë libra, dokumente, regjistra a veprime të saj për inspektim, nga çdo agjent i ligjshëm i Bankës së Shqipërisë, ose

iii) Ka një shkelje të ndërgjegjshme ose të vazhdueshme të një urdhëri të Bankës së Shqipërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji .

Kujdestari fillimisht do të emërohet brenda 5 ditëve pune pas vendimit të Bankës së Shqipërisë, sipas këtij neni.

Neni 50
**Kriteret për emërtimin e kujdestarit ose administratorit të falimentimiit**

Banka e Shqipërisë do të konfirmojë emërimin fillestar të një kujdestari ose do të emërojë një administrator falimentimi, brenda 60 ditësh nga emërimi fillestar i kujdestarit. Vendimi për emërimin synon mbajtjen ose sistemimin e shumës më të madhe të aktiveve të bankës ose institucionit financiar që kryen veprimtari bankare për një periudhë kohe që do të gjykohet e arsyeshme.

A. Për një vendim të tillë Banka e Shqipërisë do të mbështetet në këta faktorë:

i) Çmimin që ka të ngjarë të paguhet për bankën ose institucionmin financiar, nëse shitet brenda një viti.

ii) Mundësinë e ripërtëritjes së bankës ose institucionin financiar, në një insitucion të shëndoshë financiarisht dhe shumave reale e aktiveve të tyre brenda dy vjetëve.

iii) Shumën e aktiveve që ka mundësi të rikuperohen gjatë likuidimit brenda periudhës prej 2 vjetësh.

B. Banka e Shqipërisë do të vlerësojë jo më rrallë se një herë në tre muaj progresin e gjendjes së kujdestarisë.

i) Nëse Banka e Shqipërisë përcakton se banka ose institucioni financiar që kryen veprimtari bankare është ripërtërirë në një gjendje të kënaqshme financiare, çka evidentohet nëpërmjet gjendjes së pasurisë neto e cila duhet të jetë jo më pak sesa kërkohet nga zbatimi i rregullave mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, atëherë kujdestaria pushon së vepruari dhe banka ose institucioni financiar do të kthehet në zotërimin dhe kontrollin e aksionerëve të tij.

ii) Administratori falimentimi i emërohet nga Banka e Shqipërisë, nëse Banka e Shqipërisë përcakton:

a) Në çdo kohë brenda 18 muajve të emërimit të kujdestarit, kur kujdestaria nuk ka arritur të ruajë më tej aktivet e bankës ose institucionit financiar që kryen veprimtari bankare, sesa mund ta bënte këtë administratori falimentimit.

b) Brenda 18 muajve nga data e emërimit të kujdestarit, kur banka ose institucioni financiar që kryen veprimtari bankare nuk është shitur, ose shndërruar në një gjendje të kënaqshme sipas shkronjës

B (paragrafi i).

c) Pas 1 viti nga emërimi i kujdestarit, kur banka ose institucioni financiar që kryen veprimtari bankare është në paaftësi paguese sipas nenit 49 (i/a).

Neni 51

**Njoftimi i gjendjes së kujdestarisë ose i kujdestarisë së likuidimit**

Kur kujdestari ose administratori i falimentimit emërohet në bazë të neneve 49 ose 50, kujdestari a administratori i falimentimit, sipas rastit, brenda 3 ditëve nga emërimi, do të:

a) dërgojë në çdo zyrë të bankës ose institucionit financiar që kryen veprimtari bankare një njoftim që flet për një masë të tillë sipas këtij ligji, duke përcaktuar datën dhe kohën në të cilën do të hyjë në fuqi vendimi për marrjen në dorë të bankës ose institucionit nga kujdestari ose administratori falimentimit;

b) publikojë njoftimin për të njëjtën arsye në një a më shumë nga gazetat më të qarkullueshme në rajonet ku banka ose institucioni financiar ka zyrat e tij.

c) dërgojë kopje të njoftimeve të tilla në Bankën e Shqipërisë brenda tri ditëve nga postimi ose publikimi i njoftimit sipas shkronjave “a” dhe “b” të këtij neni.

Neni 52

**Ankimi për heqjen e gjendjes së kujdestarisë, ose kujdestarisë së likuidimit**

Procedura gjyqësore për të hequr gjendjen të kujdestarisë, ose e kujdestarisë së likuidimit të vendosur sipas nenit 49 të këtij ligji mund të kërkohen brenda një periudhe 30-ditore, data kur u emërua kujdestari ose administratori i falimentimit i bankës ose i institucionit financiar që kryen veprimtari bankare nga:

i) një ose më shumë aksionarë të bankës ose institucionit financiar që kryen veprimtari bankare dhe që posedojnë në total jo më pak se 25 për qind të çdo grupi aksionesh me të drejtë vote, të bankës ose institucionit financiar.

ii) çdo person që posedon jo më pak se 1/3 e shumës totale të depozitave, ose

iii) kreditorët që përbëjnë të paktën 1/3 e shumës totale të pretendimeve të kreditorëve

2) Gjendja e kujdestarisë ose e kujdestarisë për likudim do të vazhdojë pa kufizim gjatë periudhës së ankimit dhe çdo kërkesë tjetër apeluese ose procedurë tjetër juridike në lidhje me ankimin.

3) Gjykata do të mbajë një seancë përgatitore për çështjen në fjalë, brenda 30 ditëve nga depozitimi i thirrjes së vlefshme.

4) Brenda 30 ditëve nga përfundimi i seancës përgatitore të procedurës së ankimit, gjykata mund të hedhë poshtë kërkesën për ankimin, ose mund të urdhërojë Bankën e Shqipërisë të heqë gjendjen e kujdestarisë ose kujdestarisë për likuidim dhe ta kthejë bankën ose institucionin financiar që kryen veprimtari bankare nën zotërimin dhe kontrollin e aksionarëve të tij.

Neni 53

**Detyrat dhe kompetencat e kujdestarit**

1. Kujdestari do të ketë të gjitha kompetencat e aksionarëve, administratorëve dhe zyrtarëve të bankës ose institucionit financiar që kryen veprimtari bankare, në rast se Banka e Shqipërisë në urdhrin e emërtimit nuk kufizon autoritetin e kujdestarit. Ai mund ta drejtojë bankën, institucionin financiar në emër të tij dhe në një mënyrë që ai beson se është e përshtatshme për të qenë rruga më e mirë për të kthyer bankën ose institucionin financiar që kryen veprimtari bankare në një gjendje të shëndoshë financiare.

2. Njëkohësisht kujdestari do të jetë subjekt i rregullave, rregulloreve dhe urdhrave të lëshuara kohë pas kohe nga Banka e Shqipërisë dhe që ajo i mendon të përshtatshme, përveç rasteve kur shprehet ndryshe në të tilla rregulla, rregullore e urdhra . Kujdestari gëzon të njëjtat të drejta dhe privilegje dhe do të jetë subjekt i të njëjtave detyra, kufizimeve, gjobave dhe kushteve, si dhe administratorët, nëpunësit ose punonjësit e bankës ose institucionit financiar të licencuar sipas këtij ligji.

3. Banka e Shqipërisë mund t'i kërkojë kujdestarit lënien mënjanë dhe vënien në dispozicion për tërheqje nga depozituesit dhe pagesat për kreditorët e tjerë të shumave të tilla që sipas mendimit të Bankës së Shqipërisë mund të përdoren pikërisht për këtë qëllim. Gjithë depozituesit dhe kreditorët, të cilët janë në pozita të njëjta, duhen trajtuar njësoj.

4. Kompetencat e aksionarëve, administratorëve dhe nëpunësve të bankës ose institucionit financiar që kryen veprimtari bankare pezullohen gjatë gjendjes së kujdestarisë ose kujdestarisë për likuidim. Megjithatë nëpunësit dhe administratorët mund të instruktohen nga kujdestari a administratori i falimentimit për të ushtruar funksione të caktuara për bankën dhe persona të tillë janë subjekt i pushimit nga kujdestari ose administratori i falimentimit nga postet e tyre në bankë.

Neni 54

**Kompetencat e përgjithshme dhe detyrat e administratorit të falimentimit**

a) Administratori i falimentimit ka kompetenca të plota dhe ekskluzive të drejtimit dhe kontrollit të bankës ose institucionit financiar që kryen veprimtari bankare dhe mund të marrë veprime që administratori i falimentimit i gjykon të arsyeshme si rruga më e mirë për të likuiduar bankën ose institucionin financiar që kryen veprimtari bankare, për të realizuar shumën më të madhe të aktiveve, pa përmendur që licenca e bankës ose e institucionit financiar ka qenë revokuar.

b) Vetëm nenet e ligjit nr.8017, datë 25.10.1995 "Për procedurat e falimentimit", me ndryshimet ose modifikimet e nevojshme, do të zbatohen për procedurat e paaftësisë paguese të institucionit financiar, ose likuidimit të një institucioni financiar, neni 9(3), për paraqitjen dhe vërtetimin e pretendimeve, neni 14 mbi detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit të falimentimit, neni 15 mbi përfundimin e kontratave , neni 16 mbi kundërshtimin e veprimeve ligjore, neni 33 mbi vlerësimin e pasurisë dhe përmbushjen e pretendimeve, nenet 21, 23, 34, mbi ndarjen e pasurisë midis kreditorëve, neni 37 mbi ankimet.

Neni 55

**Kontabilizimi i veprimeve të likuidimit në Bankën e Shqipërisë**

a) Pas shpërndarjes së të gjithë aktiveve të bankës ose institucionit financiar që kryen veprimtari bankare në vijim të procesit të likuidimit, administratori i falimentimit hap një llogari në Bankën e Shqipërisë.

b) Me miratimin e kësaj llogarie nga Banka e Shqipërisë, Banka e Shqipërisë dhe administratori i falimentimit kanë të drejtë të shlyejnë nga kjo llogari çdo detyrim tjetër që rrjedh nga likuidimi i bankës ose institucionit financiar që kryen veprimtari bankare.

Neni 56

Kërkesat e Bankës së Shqipërisë për fondet e dhëna bankës gjatë vënies nën kujdestari, kanë përparësi ndaj të gjitha kërkesave të tjera mbi këtë bankë.

Neni 57

Kujdestari hiqet në këto raste:

a) pas përfundimit të afatit të caktuar në vendimin për vendosjen e kujdestarisë, ose në fund të zgjatjes së këtij afati të vendosur nga Banka e Shqipërisë e të botuar në Fletoren Zyrtare;

b) kur Banka e Shqipërisë gjykon ose banka ose institucioni financiar që kryen veprimtari bankare mund të veprojë normalisht;

c) pas likuidimit të bankës ose institucionit financiar që kryen veprimtari bankare në përputhje me këtë ligj.

Neni 58

**Bankat kooperativë**

1. Bankat mund të organizohen edhe si banka kooperativë.

2. Organizimi, drejtimi, kapitalizimi, operacionet, shpërndarja e tepricave dhe likuidimi

vullnetar i bankave kooperativë do të bëhet në përputhje me dispozitat e këtij neni:

a) Banka kooperativë do të jetë person juridik dhe kanë zotësi:

i) të nënshkruajnë kontrata dhe të marrin përsipër detyrime.

ii) të nxjerrin akte nënligjore dhe të jenë subjekt i procedurave të tilla dhe

iii) për qëllime të veprimtarisë tregtare të saj, të përfitojë, të posedojë dhe disponojë pronë të luajtshme apo të paluajtshme.

b) Bankat kooperativë do të regjistrohen në regjistrim tregtar.

c) Anëtarët e bankës kooperativë janë të kufizuar në:

i) individë, të cilët paguajnë një kuotë anëtarësie fillestare, të përcaktuar nga banka, të cilët kanë depozita në bankë, dhe që kanë një lloj profesioni ose banojnë brenda një rrezeje prej 25 kilometër nga drejtoria qendrore e bankës; dhe

ii) subjekte me veprimtari tregtare të vogla lokale, të përcaktuar si persona fizikë ose juridikë, me një ose disa ortakë, me veprimtari tregtare të njohur nga ligji nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe ligjet e tjera përkatëse, të lokalizuara brenda një rreze prej 25 kilometër nga drejtoria qendrore e bankës, dhe që kanë një qarkullim vjetor më pak se 1000 herë të pagës mesatare mujore, të rajonit për të cilën bëhet fjalë, të cilët paguajnë një kuotë anëtarësie fillestare të përcaktuar nga banka.

d) Anëtarët nuk janë përgjegjës për detyrimet e bankës kooperativë. Përgjegjësia e tyre ndaj bankës do të jetë e kufizuar deri në ato detyrime të cilat ata i marrin përsipër me akte të veçanta në lidhje me bankën kooperativë.

3. Bankat kooperativë do të drejtohen nga Këshilli Drejtues që përbëhet prej të paktën tre persona të cilët qëndrojnë në detyrë për një afat prej 4 vjetësh, të zgjedhur nga anëtarët e bankës dhe që mund të rizgjidhen.

a) Çdo anëtar i bankës kooperativë , në kohën e ushtrimit të veprimtarisë së Asamblesë së Përgjithshme, ka të drejtën e një vote.

b) Këshilli do të përcaktojë me akte nënligjore drejtimin e punëve të tij dhe që është subjekt i miratimit më parë nga Banka e Shqipërisë.

4. Gjendja e llogarisë tepricë në fillim do të jetë 1/3 e shumës së kapitalit minimum të kërkuar kohë pas kohe nga Banka e Shqipërisë për të licencuar bankat e reja dhe mund të jetë në formën e detyrimeve të borxhit në varësi nga kërkesat e depozituesve me një afat mesatar maturimi prej 5 vjetësh. Pas 5 vjetësh të fillimit të veprimtarisë, një bankë kooperativë do të ketë një llogari tepricë të barabartë me 10 për qind të aktiveve gjithsej.

5. Kredi mund të jepen vetëm për individë dhe për subjekte lokale me veprimtari tregtare të vogla. Kredia për një huamarrës të vetëm apo grup-huamarrësish të lidhur është e kufizuar deri në 100 herë të pagës mesatare mujore të rajonit në fjalë, përveç në rastin e kredive për blerje të shtëpive nga ana e huamarrësit.

6. Bankat kooperativë do të kalojnë tepricën, e cila del nga të ardhurat që tejkalojnë shpenzimet dhe taksat në një llogari tepricash. Nëse në një vit financiar llogaria e tepricës tejkalon 10 për qind të totalit të aktiveve, atëherë një tepricë e tillë mund, me vendim të këshillit të drejtuesve, t'u shpërndahet anëtarëve në raport me depozitat e tyre gjendje, 6 muaj përpara datës së mbylljes së bilancit.

7. Bankat kooperativë mund të likuidohen vullnetarisht me:

i) votim të anëtarëve që zotërojnë 75 për qind të shumës së depozitave të bankës 30 ditë përpara votimit, dhe

ii) miratim të Bankës së Shqipërisë.

a) Kërkesa e bërë në Bankën e Shqipërisë për miratimin e likuidimit vullnetar të bankës do të shoqërohet me:

i) Një kopje të duhur autentike të vendimit të depozituesve të bankës për të likuiduar bankën.

ii) Një përshkrim të arsyeve për likuidimin e propozuar.

iii) Një plan likuidimi, duke përfshirë një grafik kohor për likuidim.

iiii) Emrin e administratorit të falimentimit që do emërohet nga banka, së bashku me një përshkrim të cilësive profesionale të tij (saj) përvojën dhe

iiiii) Informacion të mjaftueshëm, duke përfshirë raportin e vitit të fundit financiar të kontrolluar nga një kontrollor i pavarur, i pranueshëm nga Banka e Shqipërisë, për t'ia treguar Bankës së Shqipërisë, që banka ka aftësi paguese dhe aktivet e saj janë likuide e të mjaftueshme për të shlyer

detyrimet e saj brenda periudhës së propozuar në planin e likuidimit.

b) Brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës dhe informacionit të nevojshëm, Banka e Shqipërisë do të informojë pronarët e bankës për vendimin e saj lidhur me kërkesën. Nëse kërkesa nuk pranohet, vendimi do të përmbajë edhe arsyet për mospranimin. Nëse kërkesa miratohet, vendimi do të përmbajë revokimin e licencës së bankës dhe do të botohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në një ose më shumë gazeta më të qarkullueshme në çdo qytet ku janë zyrat e bankës.

Neni 59

**Ankimet ndaj vendimeve të Bankës së Shqipërisë**

1. Bankë a institucioni financiar që kryen veprimtari bankare për të kryer veprime bankare, i cenuar nga një urdhër, vendim ose rregull i Bankës së Shqipërisë për të cilin banka ose institucioni financiar mendon se është i kundërligjshëm, mund të depozitojë një ankesë në Gjykatën e Apelit. Urdhëri i Bankës së Shqipërisë zbatohet pa kufizim gjatë periudhës së ankimit për sa kohë që Gjykata e Apelit nuk ka vendosur shprehimisht ndaj urdhërit të Bankës së Shqipërisë, pas dëgjimit të çështjes në fjalë.

2. Për masën e marrë Banka e Shqipërisë sipas këtij ligji ose ligjit nr.8076, datë 22.2.1996 "Për Bankën e Shqipërisë" gjykata vendos vetëm:

a) nëse Banka e Shqipërisë ka vepruar në kundërshtim me ligjin, dhe

b) nëse administratorët ose këshilltarët e Bankës së Shqipërisë, të angazhuar për të përfaqësuar ose ndihmuar Bankën e Shqipërisë, nuk do të jenë përgjegjës për dëmet, veprimet ose neglizhimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre për Bankën e Shqipërisë. Ata janë përgjegjës vetëm nëse veprime të tilla ose neglizhime janë të qëllimshme.

KREU IX
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 60

Banka ka emblemën dhe vulën e saj me shënjat përkatëse.

Neni 61

Bankat e nivelit të dytë dhe institucionet financiare që kryejnë veprimtari bankare detyrohen të paguajnë tatimet dhe taksat e parashikuara me ligj.

Neni 62

Institucionet që veprojnë si bankë në kohën kur ky ligj hyn në fuqi, duhet të kërkojnë të pajisen me licencë për të vazhduar veprimtarinë si bankë në përputhje me këtë ligj.

Neni 63

Ligji nr.7560, datë 28.4.1992 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet.

Neni 64

Ky ligj hyn në fuqi më 1 mars 1996.

**Shpallur me dekretin nr.1404, datë 11.3.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha**